

PKR.nr.488/15

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Naser Foniqi, me procesmbajtësen Sevdije Breznica, në çështjen penale të akuzuarit B.K., i akuzuar për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit tjetër të rrezikshëm, nga neni 375, par. 2, të KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.nr.880/2013, të datës 31.08.2015, në shqyrtimin fillestar, të hapur, të mbajtur më datë 20.06.2018, në të cilin ishin të pranishëm: Prokurori i shtetit Javorka Princevic, i akuzuari B.K. dhe përkthyesja e gjykatës Blerta Krusha, pas shqyrtimit fillestar, të njëjtën ditë, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

**I akuzuari B.K.**, i biri i H. dhe R., e vajzërisë V., i lindur me datë..., në Prishtinë, rr. "H.J.", nr. ..., me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i pa papunë - i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

### Ë S H T Ë F A J T O R

**S e p s e:** me datë 25.07.2013, rreth orës 19:45, në mënyrë frikësuese dhe kërcënuese ka përdorë pa autorizim pistoletën me gas të markës "Ekol Special", me numër serik 12120119, në atë mënyrë që derisa ka qenë duke vozitë veturën e markës "Mini Kuper", ngjyrë hiri, me targa ..., nga drejtimi i Prishtinës, në drejtim të Lipjanit, në afërsi të QMI-së, kur ka tentuar ta tejkalonte veturën e markës "Mercedes", vozitësi i së cilës, tani i dëmtuari J.K., ka ndaluar pasi që është detyruar që t'i jap përparësi kalimi veturave tjera nga drejtimi i kundërt i rrugës, me ç rast i pandehuri fillimisht ka filluar të shaj e të bërtas të dëmtuarit dhe bashkudhëtarit të tij tani të dëmtuarit H.M., e më pas ka marrë nga vetura pistoletën me të cilën ka shtënë një herë me qëllim që t'i frikësojë tani të dëmtuarit, e pas ngjarjes zyrtarët policor në vendin e ngjarjes kanë gjetur dhe sekuestruar një gëzhgjë të shkrepur nga arma e kalibrit 6mm, ndërsa arma i është sekuestruar me datë 31.07.2013, në shtëpinë e të akuzuarit, lidhur me një rast tjetër penal,-

- me këtë, ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit tjetër të rrezikshëm, nga neni 375, par. 2, të KPRK.

Prandaj gjykata në bazë të neneve: 41; 45; 46; 47; 73; 75; 76, par. 1, nënpar. 1.5, dhe 375, par. 2, të KPRK, si dhe neni 365, të KPPK, të akuzuarit, i shqipton:

- **Dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesë (5) muaj, dhe**
- **Dënim me gjobë në shumë prej katërqind (400) €,**
- **Në bazë të neni 47 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës**, me pëlqimin e të pandehurit **B.K.**, dënimi me burgim i zëvendësohet në dënim me gjobë **në shumë prej gjashtëqind (600) €,** të cilën gjobë, i pandehuri obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë
- Obligohet i pandehuri të paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas listës së shpenzimeve, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të

paguaj shumën prej **pesëdhjetë (50) €**, si dhe **pesëdhjetë (50.00) €**, për **Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit**, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

- Të akuzuarit i konfiskohet gëxhoja e kalibrit 6 mm, e cila është përdorur me rastin e kryerjes së veprës penale.
- Të dëmtuarit: J. (H.) I., nga Sh., rr. “A.J.”, nr. ... dhe H.(R.)M., nga fshati G. i U., Komuna L., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

## A R S Y E T I M I

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.nr.880/2013, të datës 31.08.2015, e ka akuzuar B.K., për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit tjetër të rrezikshëm, nga neni 375, par. 2, të KPRK.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari B.K., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, duke shtuar se e ka parasysh natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe se ai e di se për këtë rast ndaj tij mund të shqiptohet një dënim. Po ashtu, i akuzuari ka deklaruar se ndihet i penduar për këtë rast dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris raste të tilla.

Sa i përket pranimin të fajësisë nga i akuzuari, Prokurori i shtetit deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari B.K., dhe i ka propozuar gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta pranoi, e pastaj i njëjti të shpallet fajtorë dhe të dënohet sipas ligjit. Ndërsa, ka shtuar se sa i përket caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, i ka propozuar gjykatës që t’i ketë parasysh të gjitha dëshmitë e propozuara në aktakuzë, rrethanat sociale të të akuzuarit dhe të kaluarën e tij kriminale.

Pas deklarimit të të akuzuarit se ndihet fajtorë për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe deklarimit të prokurorit të shtetit, gjykata me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi është bindur se ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht nga i akuzuari.

Po ashtu, edhe nga shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale, Përdorimi i armës apo mjetit tjetër të rrezikshëm, nga neni 375, par. 2, të KPRK.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që, ndaj të akuzuarit, gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese siç janë: pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që i njëjti edhe në procedurë paraprake gjatë marrjes në pyetje në polici e ka pranuar fajësinë; intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur (në këtë rast të dëmtuarit nuk kanë pësuar ndonjë lëndim trupor, ashtu siç kanë deklaruar në marrjen në pyetje në prokurori me datë 22.06.2018); motivet për kryerjen e veprës penale (rasti ka ndodhur aty për aty sepse edhe të dëmtuarit edhe i akuzuari në deklaratat e dhëna në polici kanë thënë se nuk janë njohur më parë dhe nuk kanë pasur ndonjë mosmarrëveshje mes vete) dhe keqardhjen e shprehur nga i akuzuari pas kryerjes së veprës penale. Ndërsa, si

rrethanë rënduese gjykata ka marrë faktin se i akuzuari edhe më parë ka qenë i dënuar sipas aktgjykimeve të kësaj gjykate: PKR.nr.22/18 - dënim me kusht; PKR.nr.597/15 – dënim me burg dhe me gjobë dhe PKR.nr.329/13 – dënim me burg. Kështu që, duke u bazuar në rrethanat lehtësuese të paraqitura si më lart gjykata ka zbutur dënimin ndaj të akuzuarit,

duke vlerësuar se edhe me një dënim më të butë se dënimi i paraparë me dispozitat e KPRK, mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Andaj, gjykata të akuzuarit si më lart i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale për të cilat i akuzuari edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar ndaj tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëj rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Po ashtu, gjykata ka zbutur dënimin ndaj të akuzuarit si më lart, duke pasur për bazë se i njëjti e ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer, ka qenë shumë i sinqertë ndaj gjykatës dhe se edhe me dënimin më të butë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Pas shpalljes së aktgjykimit, i akuzuari është deklaruar se e pranon dënimin e shqiptuar dhe ka pranuar që ky dënim t'i zëvendësohet me dënim me gjobë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 1, të KPPK, **ndërsa vendimi mbi taksën për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të neneve: 3; 6 dhe 39, par. 3.2 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.**

**Vendimi që të pandehurit t'i merret sendi i përdorur për kryerjen e veprës penale, u mor në bazë të nenit 375, par. 3, të KPRK.**

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 365, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 20.06.2018.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA  
PKR.nr.488/15, datë 20.06.2018.**

Procesmbajtëse,  
Sevdije Breznica

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,  
Naser Foniqi

#### **UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë.

Nga një kopje e këtij aktgjykimi i dorëzohet:  
prokurorit të shtetit dhe të akuzuarit.